



UNIVERSITETI "KADRI ZEQA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Procesverbal i Mbledhjes së IV-të të KMCV

Mbajtur më: 25.02.2022, me fillim në orën 11.00,

Salla: A34, UKZ

Pjesëmarrës: Prof. Dr. Xhevdet Thaqi, Prof.Ass. Dr. Bashkim Dalipi, Prof.Ass.Dr. Fatmire Krasniqi, Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, Studentja Leurina Guda, Refik Ibrahimimi dhe Fitore Malaj.

Munguan: Prof.Asoc. Dr. Ekrem Alimi, Prof.Ass.Dr. Ragmi Mustafa dhe studentja Sara Keçmezi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi Prof.Dr. Xhevdet Thaqi, i cili për këtë takim propozoi këtë

Rend Dite

1. Miratimi i Rendit të Ditës
 2. Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së III-të të KMCV-së
 3. Zbatimi i Kalendarit të Cilësisë, fillimi i semestrit veror 2021/2022
 4. Shqyrtimi i të dhënave për shkallën e kalueshmërisë së studentëve për secilën lëndë
 5. Shqyrtimi i shkallës së implementimit të PZHI-së për stafin akademik 2021-2022
 6. Organizimi i Konferencës vjetore të UKZ-së 2022
 7. Të ndryshme
1. Pas prezantimit të Rendit të Ditës, kryesuesi kërkoi ndonjë propozim nga të pranishmit për ndonjë propozim në të ndryshme.

Lidhur me këtë Fitore Malaj propozoi që në të ndryshme të diskutohet lidhur e me aprovimin nga KSHC për monitorimin e IAL –ve nga AKA lidhur me përmbushjen e zotimeve në rekomandimet e ekspertëve.

Të gjithë u pajtuan dhe ky propozim u fut në rend dite si dhe u miratua nga anëtarët e KMCV-së.
 2. Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës Kryesuesi kërkoi që të miratohet Procesverbali i mbledhjes së III-të. Pjesëmarrësit e miratuan njëzëri.

3. Në pikën e tretë të rendit të ditës fjalën e mori Fitore Malaj e cila foli për implementimin e Kalendarit Vjetor për Sigurim të Cilësisë. Në fjalën e saj ajo tregoi për vështërsitë të cilat po i has në zbatim dhe njëkohësisht kërkoi nga annëtarët e KMCV-së që të bartin në fakultetet e tyre që të kenë parasysh përgjegjësitë që kanë rreth përmbushjes së detyrave lidhur me kalendarin. Në fjalën e saj ajo potencoi edhe detyrimin që ka në hartimin e një raporti përfundimtar lidhur me të gjitha aktivitetet e parapara në Kalendarin Vjetor të Cilësisë në UKZ.

Po ashtu në këtë pikë të rendit të ditës u diskutua edhe lidhur me fillimin e semestrit veror. Prodekania Fatmire Krasniqi foli rreth freskimit të ueb faqes, ku kërkoi që Koordinatorët e Cilësisë të kryejnë punën e tyre. Këtë propozim e përkrahën të gjithë dhe u vendos që urgjentisht të punohet në publikimin e të dhënave në web faqen e UKZ në të gjitha NJA të UKZ-së, duke filluar nga publikimi dhe freskimi i CV-ve, syllabuset, linqet e publikimeve etj., për të gjithë stafin akademik të rregullt, të angazhuar dhe asistentët.

U vendos që **afati kohor** për kryerjen e kësaj pune të jetë dy javë, përkatësisht jo më larg se 15 Mars 2022.

Prodekani Bashkim Dalipi foli lidhur me publikimin e orarit në ueb si dhe fillimin e semestrit veror, përcaktimin e datave, në kohën e duhur si për studime baçelor poashtu edhe për studime master. Prodekani Bashkim, propozoi që të shqyrtohet mundësia e ri-dizajnimit të ueb faqes së UKZ.

4. Në kuadër të pikës së katërtë të rendit të ditës, lidhur me shqyrtimin e të dhënave për kalueshmërinë e studentëve në secilën lëndë, Kryesuesi kërkoi që të kërkohet nga Koordinatorët e Cilësisë të mbledhen të dhënat për të gjitha programet studimore.
5. Shqyrtimi i shkallës së implementimit të PZHI-së për stafin akademik 2021-2022, u diskutua në pikën e 5 të rendit të ditës. U diskutua për vështërsitë të cilat po i hasin SA në plotësim të PZHI-së dhe u propozua që të rishikohet Manuali për Vlerësim gjatë muajit Qershor dhe Korrik 2022.
6. Në pikën 6 të rendit të ditës u diskutua lidhur organizimin e Konferencës Vjetore të UKZ-së e cila do të mbahet më 30-31 maj 2022. Kryesuesi prezantoi një draft të agjendës së Konferencës ku pjesëmarrësit u njoftuan në detaje.
7. Në të ndryshme u diskutua për përgatitjet e bartësve të programeve studimore lidhur me përmbushjen e zotimeve karshi rekomandimeve të eksperteve ndërkombëtarë gjate akreditimit të programeve. U propozua që koordinatori e NJA të përgatitin një Raport lidhur me planin e zbatimit të Rekomandimeve të ekspertëve për secilin program të akredituar. ***Ky raport duhet të dorëzohet në Zyrën ZZHAC, dhe jo më larg se më 20.03.2022.***

Procesmbajtësi

Fitore Malaj

Kryesuesi i KMCV

Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi